



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:205690

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05523679

KF.nr.414/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Z.B.” B.I, me seli në Prizren, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti garancion bankar, vlera e kontestit e pa përcaktuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të paditësit, Z.B., pronari personalisht, dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur XH.K., me datë 26.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Z.B.” B.I, me seli në Prizren, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI aktvendimi 01.3.2.2/10963 i datës 13.08.2021, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Z.B.” B.I, me seli në Prizren, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 15.09.2021, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ kundër vendimit 01.3.2.2/10963 të datës 13.08.2021 të të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, për shkak të shkeljes së ligjeve të doganës dhe shkeljes së procedurës administrative. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor - kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se: Për qëllime të verifikimit të origjinës, gjatë procedurës së zhdoganimit të mallit më është dashur të deponoj një garancion bankar për DK, ashtu që të mund të tërhiqi mallin dhe garancioni mbetet deri në verifikimin e origjinës nga Dogana. Dogana pas verifikimit të origjinës ka konstatuar se origjina është e saktë, andaj më nuk ka nevojë që edhe më tutje të mbahet garancioni bankar. Pas kësaj unë kam shkuar në doganë

për të kërkuar kthimin e garancionit por se të njëjtit më kanë thënë se nuk të takon kthimi i garancionit. Andaj, unë kërkoj nga gjykata kthimin e primit të garancionit të paguar për taksat doganore. Për shkak të verifikimit të kërkuar nga Dogana e Kosovës më është dashur të deponoj garancionet bankare e të cilat garancione bankare është fakt se më janë kthyer, mirëpo unë për këto garancione bankare për dy vite kam paguar prime në shuma të caktuara e të cilat shuma - prime të pagesave për garancione bankare nuk më janë kthyer nga e paditura, e kthimin të cilave e kërkoj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 29.01.2024 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marr komfor të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: Nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe plotësim të saj dhe gjatë kësaj seance. Garancionet bankare janë kthyer me datë 04.06.2021, të pranuar nga paditësi dhe për këtë paraqesë provë garancionet bankare të nënshkruara nga vetë paditësi së bashku me shkresën nga Sektori i Mbikëqyrjes së Tranzitit dhe Garancioneve, si dhe shkresa apo kërkesa për verifikim të origjinës si dhe kërkesa e paditësit i cili ka kërkuar vazhdimin e garancioneve. Në bazë të dispozitave të KDA-së, neni 55 parg 2, thuhet se dogana mund të kërkoj nga zotëruesi i mallit të paraqet një garancion me qëllim të sigurohet për pagesën e borxhit doganor. Nga administrimi i provave, paditësi me asnjë prove relevante juridike nuk mund të provojë se Dogana e Kosovës i ka shkaktuar dëm. Andaj, nga kjo i propozoj gjykatës që të refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 26.03.2024, ka administruar provat dhe atë: aktvendimin 01.3.2.2/10963 të datës 13.08.2021, përgjigjen në padi të datës 29.01.2024, ankesën e ushtruar në Doganë të datës 17.06.2021, parashtresën e Doganës të datës 10.06.2020, 20.03.2019, garancionin për taksat e importit nr.070030060013937, 070030060013890, parashtresën kthim i garancioneve bankare të datës 03.06.2021, emailin - korrespondencën e datës 03.06.2021, 30.11.2020, 03.03.2021, EUR1 nr.187819, dhe kërkesën për vazhdim të garancioneve bankare të datës 10.06.2020

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat shkresore të administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, Gjykata ka nxjerr konstatimin se e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë me aktvendimin e kontestuar me 01.3.2.2/10963 të datës 13.08.2021, e ka hedhur poshtë kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit për shkak të inkopetencës lëndore, me arsyetim se kërkesat reale të palës në procedurë janë që të kthehen mjetet e paguara për primin e garancioneve bankare të depozituara në Doganë, andaj Dogana e Kosovës ka shqyrtuar me kujdes kërkesën e palës dhe askund nuk ka gjetur dispozita ligjore tek Kodi Doganor dhe i Akcizave që rregullon këtë çështje. Tutje ka theksuar se fletë-garancionet i janë kthyer subjektit në procedurë, kurse lidhur me shumën të cilën e kërkon në emër të primit, Dogana e Kosovës i sqaron se nëse i njëjti pretendon se është i dëmtuar, atëherë mund të hapë kontest civilo-juridik në raport me Doganën e Kosovës pranë gjykatës kompetente.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me aktvendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Gjykata vlerëson se nuk qëndron pretendimi i paditësit se të njëjtit nuk i janë kthyer garancionet bankare, kjo për faktin se nga shkresat e lëndës vërtetohet se subjektit në procedurë këtu paditësit i janë kthyer garancionet bankare nr.070030060013927 dhe nr.070030060013890, të cilat garancione subjekti në procedurë i ka pranuar me datën 04.06.2021, ngase Sektori i Origjinës ka konstatuar se malli i deklaruar nga subjekti në procedurë konsiderohet mall me origjinë preferenciale të shtetit të deklaruar, dhe se me këtë janë përmbushur detyrimet doganore ndaj Doganës së Kosovës.

Gjykata po ashtu vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur e ka hedhur poshtë si të pa pranueshme kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit për kthimin e mjeteve në emër të pagesës së primit kompanisë së sigurimeve, kjo për faktin se me nenin 15 par.1 të LKA-së,

përcaktohet se “Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet: kundër akteve të nxjerra në çështjet, në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ”. Ndërsa me nenin 17 të LKA-së, përcaktohet se “Në procedurën e konfliktit administrativ mund të kërkolet edhe kthimi i sendeve të marra, si dhe kompensimi i dëmit që i është shkaktuar paditësit me ekzekutimin e aktit që kontestohet”. Pra në rastin konkret kërkesa e subjektit në procedurë këtu paditësit nuk ka të bëjë me ndonjë dëm i cili i është shkaktuar me ekzekutimin e vendimit, mirëpo është kontest juridiko civil për të cilin është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ, andaj, sipas vlerësimit të gjykatës e paditura drejtë ka vendosur kur të njëjtin e ka udhëzuar kontestin e rregullt juridiko-civil në raport me Doganën e Kosovës pranë gjykatës kompetente.

Si përfundim, Gjykata konsideron se aktvendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi i Doganës së Kosovës në Prishtinë 01.3.2.2/10963 i datës 13.08.2021, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par. 1 dhe 46 par. 1 dhe 2 të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë / Departamenti Fiskal

KF.nr.414 /2022, datë 26.03.2024

Zyrtare Ligjore

Amire Jahiri

Gj y q t a r i

Fisnik Nuli

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate